

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA TIRANË  
INSPEKTORATI I MBROJTJES SË TERRITORIT  
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

### **SHPALLJE POZICIONI VAKANT**

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës, shpall procedurën e konkurimit për vendin e lirë të punës për pozicionin:

#### **Specialist I-rë, Sektori Juridik & Ankimimet, Drejtoria Juridike (Kategoria III-b).**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”; VKB Nr.169 datë 24.12.2021 “Për Organizimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit”, institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës; Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Nr.414, datë 06.01.2023 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit”, institucion në varësi të Bashkisë Tiranë;

#### **Kërkesat e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve :**

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar ;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje ;
- Diplomë(Bachelor + Master Profesional/Shkencor) ose Diplomë e Nivelit të Dytë), (për diplomat jashtë vendit, të përcillet njehsimi nga MAS);
- Të ketë njohuri të mira të paketës Microsoft Office;
- Zotërimi i nje gjuhe të huaj përben avantazh;
- Të ketë aftësi të mira drejtuese,menaxhuese, raportuese, komunikimi dhe të punës në grup;

#### **Specialist I-rë ka për detyrë si më poshtë:**

Specialist Jurist i I-rë varet nga Përgjegjësi i Sektorit Juridik dhe Ankimimet, dhe kryen këto detyra:

- a) Zbaton programin e punës sipas miratimit nga Drejtori i Drejtorisë, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;
- b) Jep këshilla, opinione dhe ndihmë juridike, me iniciativë apo sipas kërkesës, për të gjitha strukturat e IMT- së në drejtim të njohjes, interpretimit dhe zbatimit rigoroz të Kushtetutës dhe akteve ligjore e nënligjore në fuqi;
- c) Jep këshillimin e nevojshëm ligjor dhe opinionin juridik për veprimtarinë inspektuese të IMT sa herë që kërkohet dhe është e nevojshme për vendimmarrje;
- d) Jep këshilla, opinione dhe ndihmë juridike për hartimin e akteve administrative në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi;
- e) Vë në dispozicion të stafit të IMT- së, të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore që i kërkohen;
- f) Angazhohet në përpilimin e urdhrave dhe udhëzimeve të brendshme të Kryeinspektorit.
- g) Angazhohet në ndjekjen e proceseve kontraktuale, administrative, përmbaremore të cilat i drejtohen IMT-së sipas kërkesave ligjore në fuqi.

- h) Ndjek në të gjitha shkallët e shqyrtimit apo të gjykimit me autorizim të Kryeinspektorit të gjithë proceset administrative apo gjyqësore, ku institucioni është palë ndërgjyqëse paditëse ose e paditur dhe në raste kur IMT është person i tretë, edhe në bashkëpunim me DPJAL në Bashkinë e Tiranës.
- i) Kontribuon në zgjidhjen e kërkesave apo ankesave drejtuar IMT, duke këshilluar strukturat përgjegjëse për trajtimin e tyre në lidhje me çështjet me natyrë ligjore e juridike.
- j) Ndjek dhe monitoron konfliktet gjyqësore me të cilat IMT është palë ndërgjyqëse duke organizuar punën në mënyrë produktive në rastet kur Institucioni paditet në Gjykatë në të gjitha shkallët e gjykimit.
- k) Koordinon, mbikqyr dhe siguron në mbrojtje të Interesave të IMT:
  - a. realizimin e përgatitjeve të prapësimeve në Gjykatën e Shkallës së Parë
  - b. kërkesave të ndërmjetëme
  - c. kërkesave ankimore në Gjykatë
- l) Kordinon ndjekjen e veprimeve procedurale duke respektuar kërkesat, procedurat dhe afatet ligjore në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të BT:
  - për zbatimin e vendimeve gjyqësore që kanë marrë formë të prerë
  - përgatitjen e kërkesave përkatëse në rastet e kundërshtimit të kërkesave për pezullimin e ekzekutimit të vendimeve të formës së prerë në Gjykatën e Lartë.
- m) Monitoron përgatitjen e njoftimeve për marrjen dijani të subjekteve ankimues në lidhje me vendimet e Kryetarit, struktura akti i të cilave është ankimuar.
- n) Ndjek shqyrtimin e të gjitha procedurave për ankimet administrative të subjekteve private që kundërshtojnë veprimet e Inspektoratit, sipas kërkesave të eprorit duke ju përmbajtur objektivave dhe afateve të përcaktuara.
- o) Vlerësim juridik i procedurave për kundërvatjet e konstatuara në terren.
- p) Përgatitje e dokumentacionit dhe kërkesave për lëshim urdhëri ekzekutimi për masat administrative dënim me gjobë, drejtuar gjykatës.
- q) Ndjekje e procedurës ligjore për vjeljen e gjobave të vendosura nga IMT nëpërmjet shërbimit përmbarimor.
- r) Sugjeron dhe monitoron përgatitjen e materialeve të duhura informuese për IMT në lidhje me përgatitjen e ankesave ankimore, rekurse, memo, draft vendimeve duke vlerësuar të gjitha mundësitë procedurale në bashkëpunim me strukturën juridike në Bashkinë Tiranë.

**Dokumentat që aplikanti për Specialist I-rë në Sektorin Juridik&Ankimimet, Drejtoria Juridike duhet të paraqesë janë si më poshtë:**

1. CV;
2. Kopje ID;
3. Diplomë ( Bachelor + Master Profesional/Shkencor) ose Diplomë e Nivelit të Dytë, dhe listë notash të noterizuara (*për diplomat jashtë vendit, të përcillet njëhësi nga MAS*);
4. Çertifikatë personale dhe familjare;
5. Librezë pune origjinale;
6. Raport mjeko – ligjor;
7. Dëshmi penaliteti;
8. 2 fotografi;
9. Çertifikata, kualifikime etj (nëse dispononi)

Dërgimi i dokumentacionit do të bëhet pranë Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit në adresën : Rr. “Abdi Toptani”, 1001, Tiranë, afati është deri me datë 12.10.2023.

